



**KOMUNA E RAHOVECIT**  
**OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC**  
**ANEKS KONTRATA**

Numri i kontratës:<sup>1</sup> 623-21-9916-5-2-5/C345

Numri i Brendshëm: 623-19-026-5-1-1/5

**KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË**, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe  
**"Euroasphalt" Sh.p.k. Skenderbeu (Jasht Qytetit), GJAKOVË**, (në vazhdim "Kontraktuesi"),  
në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin Aneks Kontratë për punë e shënuara me poshtë:

Titulli i Aneks Kontratës: **ASFALTIMI I RRUGËS FORTESË – HAMOC – RAHOVEC**

Me numër identifikues: 623-21-9916-5-2-5

- I. Duke pasur parasysh se palët kontraktuese të përmendura më lartë kanë lidhur kontratë mbi kryerjen e punëve për: **ASFALTIMI I RRUGËS FORTESË – HAMOC – RAHOVEC**, me Numër të prokurimit: 623-19-3572-5-1-1 & 623-19-026-5-1-1, të datës: 01.08.2019, e cila kontratë është në realizim e sipër.
- II. Duke u bazuar në kërkesën për punë shtesë nga Menaxheri i Projektit dhe arsyetimet për mospërfshirjen e punëve shtesë në kontratën bazë, në njoftimin për Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik për procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, në vendimin mbi aprovimin e punëve shtesë të kontratës dhe kryerjen e suksesshme të punëve për: **ASFALTIMI I RRUGËS FORTESË – HAMOC – RAHOVEC**, Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi pajtohen që të lidhin aneks kontratë për kryerjen e punëve shtesë sipas ofertës së datës: 03.12.2021, me kushte të njëjta si në kontratën bazë.
- III. Kontrata hynë në fuqi me datën e nënshkrimit, ndërsa ekzekutimi i punëve dhe/ose shërbimeve duhen të përfundohen në afat jo më të gjatë se: **25 ditë pune pas fillimit të ekzekutimit të Punëve dhe/ose Shërbimeve**.

<sup>1</sup> Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

**ME KËTË U PAJTUAN SI VIJON:**

- I. Kontrata bazë që është duke u përbushur, është vazhduar edhe për kryerjen e punëve shtesë të pa parashikuara si marrëveshje reciproke në mes palëve.
- II. Çmimi i punëve shtesë është gjithsej: **97,001.51 Euro;**  
(Nëntdhjeteshtatë mijë e një Euro e pesëdhjetenjë Cent)  
Sipas përshkrimeve të punëve dhe sasive të dhëna në Dosjen e tenderit numër: **623-21-9916-5-2-5/C345 & 623-19-026-5-1-1/5.**
- III. Punët shtesë kontraktohen bazuar në përshkrimin e punëve shtesë të Menaxherëve të Projektit, Njoftimit në KRPP dhe kushteve të negocuara në mes të Autoritetit Kontraktues dhe Kontraktuesit që janë pjesë e këtij Aneksi të Kontratës.
- IV. Pagesa e punëve shtesë do të bëhet në bazë të konstatimit të Personave të Autorizuar të Autoritetit Kontraktues pas perfundimit të punëve.
- V. Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:
  - a. Marrëveshja e kontratës;
  - b. Përshkrimi i punëve shtesë nga Menaxherët e projektit që duhet të realizohen;
  - c. Njoftimi në KRPP për punët shtesë.
- VI. Të gjitha kushtet tjera të kontratës bazë mbesin të njëjta.

Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën: Shqipe<sup>2</sup> në tri origjinale, Dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:		Për Kontraktuesin:	
Emri:	Astrit Mullabazi	Emri:	Fatos Deva
Pozita:	Menaxher i Prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	20.12.2021	Data:	20.12.2021
Vula:		Vula:	

<sup>2</sup> Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

**PARAMASA DHE PARALLOGARIA E PUNEVE SHITESE  
ASFALTIMI I RRUGES FORTES-HAMOC-RAHOVEC**

Nr.	Përshkrimi	Njësia Matëse	Sasia	Çmimi njësi me TVSH	Çmimi total me TVSH €
<b>I. PARAMASA E RRUGËS</b>					
Gjatësia e rrugës AKSI 0 : L=6,990.70m' dhe gjerësi B = 2x2.75 = 5.50 m'					
<b>2.0 PUNIMET E DHEUT</b>			Te realizuara		
2.1	Gërmimi i trasesë së rrugës të kategorisë III-të dhe IV-të me ngarkim dhe bartje deri në deponin të cilën e cakton organi mbikqyrës. Sasia e llogaritur në gjendje natyrale.	m³	13,562.50	0.80	10,850.00
<b>5.0 MBISTRUKTURA E RRUGËS</b>					
5.1	Furnizimi, transporti dhe punimi i shtresës së rrugës mbi nënbaz prej gurit të thyer gëlqeror 50-150mm me trashësi t=40cm me strukturë të shpërndarë sipas rregullores gjermane ZTV për shtresat mbajtëse të rrugëve, ndërsa moduli i ngjeshjes Ev2 duhet të jetë ≥50MN/m². Ngjeshja duhet të bëhet në dy shtresa nga 15.0cm.	m³	13,562.50	4.00	54,250.00
<b>Gjithsej totali me TVSH</b>					<b>65,100.00</b>

<b>4.0 OBJEKTET - LËSHESAT GYPORE</b>					
4.1	Gërmimi i dheut i kategorisë III-të dhe IV-të për themele të lëshesave me ngarkim dhe bartje deri në deponin të cilën e cakton organi mbikqyrës.	m³	16.32	1.00	16.32
4.2	Shtruarja e tamponit nën dhe mbi trupin e lëshesave t=20 cm.	m³	2.72	6.00	16.32
4.3	Punimi i lëshesës gypore: Furnizimi, bartja dhe montimi i gypave beton-arme Ø400 mm për qarkullim të ujit nga njera ane e rrugës në tjetren. Në qimim të kalkulohen edhe kokat, llyrese dhe dalese me beton C-25/30 Armatura rrjet Ø10-15/15cm. Qimimi për copë i komplet lëshesave me gjatësi: L=8.5m'.	cope	2.00	40.00	80.00
<b>Gjithsej totali me TVSH - 4.0 OBJEKTET - LËSHESAT GYPORE</b>					<b>112.64</b>

Gjatësia e rrugës AKSI 1 : L=958.50m' dhe gjerësi B = 2x2.50 = 5.00 m'					
<b>2.0 PUNIMET E DHEUT</b>			Te realizuara		
2.1	Gërmimi i trasesë së rrugës të kategorisë III-të dhe IV-të me ngarkim dhe bartje deri në deponin të cilën e cakton organi mbikqyrës. Sasia e llogaritur në gjendje natyrale.	m³	801.00	0.80	640.80
2.2	Furnizimi dhe ngjeshja e nënbazës e trupit të rrugës deri në arritjen e aftësisë mbajtëse prej 45MN/m².	m²	1,725.30	0.30	517.59
<b>4.0 MBISTRUKTURA E RRUGËS</b>					
4.1	Furnizimi, transporti dhe punimi i shtresës së rrugës mbi nënbaz prej gurit të thyer gëlqeror 50-150mm me trashësi t=40cm me strukturë të shpërndarë sipas rregullores gjermane ZTV për shtresat mbajtëse të rrugëve, ndërsa moduli i ngjeshjes Ev2 duhet të jetë ≥50MN/m². Ngjeshja duhet të bëhet në dy shtresa nga 15.0cm.	m³	925.62	4.00	3,702.48
<b>Gjithsej totali me TVSH</b>					<b>4,860.87</b>

<b>NDERTIMI I KANALIZIMIT FEKAL NË RRUGËN "FORTES, HOMOVC, RAHOVEC"</b>					
GJATËSIA E KANALIZIMIT L=960m GJËRSIA E KANALIT B=0.80m Ø250mm					
<b>2.0 PUNET TOKESORE</b>			Te realizuara		
2.6	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e zhavorit Ø0-63mm për mbulimin e gypit pas montimit të gypave në shtresa 40cm me ngjeshje mekanike dhe në lartësinë e rrugës.	m³	920.16	5.00	4,600.80
<b>Gjithsej totali me TVSH</b>					<b>4,600.80</b>



Gjatësin e rrugës AKSI 2 : L=2137.50m' dhe gjerësi B = 2x2.50 = 5.00 m'					
2.0 PUNIMET E DHEUT			Te realizuara		
2.1	Gërmimi i trasesë së rrugës të kategoris III-të dhe IV-të me ngarkim dhe bartje deri në deponin të çilen e cakton organi mbikqyrës. Sasia e llogaritur në gjendje natyrale.	m'	6,730.50	0.80	5,384.40
<b>3.0 MIBISTRUKTURA E RRUGËS</b>					
3.1	Furnizimi, transporti dhe punimi i shtresës së rrugës mbi nënbaz prej gurit të thyer gëlqeror 50-150mm me trashësi t=10cm me strukturë të shpërndarë sipas rregullores gjermane ZTV për shtresat mbajtëse të rrugëve, ndërsa moduli i ngjeshjes Ev2 duhet të jetë >50MN/m². Ngjeshja duhet të bëhet në dy shtresa nga 15.0cm.	m'	4,235.70	4.00	16,942.80
Gjithsej totali me TVSH					22,327.20
<b>REKAPITULLIMI I PUNIMEVE SHITESË</b>					
Gjithsej totali me TVSH					97,001.51 €
Gjithsejtë për pagesë me TVSH					97,001.51 €

